



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr.1024/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Glllogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Istog, Nazif Metaj, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**REFUZOHET** si i pabazuar apeli i parashtruar nga Nazif Metaj, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Istog, me shenjë ZL.Anr.1024/2017 të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

### **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.11.2017, nga Nazif Metaj, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Istog, me të cilën pretendon se në fshatin Rakosh, në Vendvotimet VV nr. 0607C/01R, 0608/01R, 0608C/02D, dyshoj se janë keqpërdorur votat e tij sepse 20 vota i ka pasur nga familjarët e tij. Më tutje ka theksuar se, në fshatin Kaliçan në vendvotimin VV nr. 0621C/01R bazuar nga Formularët e KQZ-së i ka pasur 10 vota dhe tani mendoj se e ka vetëm 1 votë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmerisë së apelit, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

## **Apeli është i pabazuar.**

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve në apel gjeti se parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë bindëse për të mbështetur pretendimet e tij në apel. Prandaj, apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë apelin e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në mbështetje të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.1024/2017 më datën 12.11.2017.



### ***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*